



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

Nr.01, datë 18.10.2023

PËR
MIRATIMIN E LEJES SË NDËRTIMIT PËR OBJEKTIN:
“RIKONSTRUKSION I MUZEUT, NDËRTIMI I FONDIT TË RI, STREHËS PËR
FONDIN E JASHTËM DHE SHKALLË EMERGJENCE
PËR MUZEUN KOMBËTAR ARKEOLOGJIK TË DURRËSIT”,
ME VENDNDODHJE NË RRUGËN “TAULANTIA”, BASHKIA DURRËS

Në mbështetje të neneve 27 dhe 28, të Ligjit Nr. 107, datë 31.07.2014 “Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 408, datë 13.05.2015 “Për miratimin e rregullores së zhvillimit të territorit”, i ndryshuar, si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.519, datë 20.09.2017 “Për përcaktimin e përbërjes së Këshillit Kombëtar të Territorit”, i ndryshuar, me propozim të zhvilluesit Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Miratimin me kusht të Lejes së Ndërtimit për objektin: “Rikonstrukcion i Muzeut, ndërtimi i fondit të ri, strehës për fondin e jashtëm dhe shkallë emergjence për Muzeun Kombëtar Arkeologjik të Durrësit”, me vendndodhje në rrugën “Taulantia”, Bashkia Durrës, me subjekt zhvillues Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit.
2. Harta e Planvendosjes së Strukturave bashkëlidhet si pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Dokumenti i Lejes së Ndërtimit i jepet subjektit kërkues vetëm pas:
 - a) plotësimit të dokumentacionit tekniko-ligjor;
 - b) pagesës së taksës së ndikimit në infrastrukturë për llogari të Bashkisë Durrës.
4. Ngarkohet Agjencia e Zhvillimit të Territorit në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit për zbatimin e këtij vendimi.
5. Ky vendim hyn në fuqi pas nënshkrimit nga Kryetari i Këshillit Kombëtar të Territorit, Ministri i Linjës dhe Sekretari i Këshillit Kombëtar të Territorit.



MINISTËR I LINJËS
MINISTËR I EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT


BLENDI GONXEJA



ANËTAR / SEKRETAR I KKT

DREJTOR I AGJENCISË SË ZHVILLIMIT TË TERRITORIT

ADELAJDA ROKA



Nënshkruar më datë 23.09 / 2024